



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 9086

NR. VENDIMI 4993

V E N D I M

“Ne emer te Republikes”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga:

GJYQTARE : BRUNILDA KADI

Asistuar nga sekretare gjyqesore Alisma Shehu, sot me date 04.06.2018, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike, çeshtjen civile nr.9086 akti, qe i perket:

**PADITES:** Shoqeria \*\*\*, shoqeri e huaj, me seli ne adrese: \*\*\*.

E perfaqesuar, sipas autorizimit te dates 23.05.2017, dhene nga perfaqesuese ligjore e shoqerise, zj. \*\*\*, nga zyra e avokatise \*\*\*\*, dhe sipas autorizimeve te dhena nga perfaqesuesi ligjor i kesaj zyre, z. \*\*\*, dt.23.05.2017, nga av. \*\*\*, me nr. \*\*\* License , dt.23.05.2017, nga av. \*\*\*, me nr. \*\*\* License, dt.28.05.2018 nga av. \*\*\*, me nr. \*\*\* License.

**I PADITUR:** \*\*\*, subjekt fizik, regjistruar me emer in tregtar “ \*\*\*\*”, me NUIS \*\*\*, me seli ne adrese: \*\*\*, perfaqesuar ne gjykim nepermjet perfaqesuesit me Prokure te Posacme nr. \*\*\*, dt. \*\*\*, av. \*\*\*, me nr. \*\*\* License.

**PERSON I TRETET:**

1.Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, me adrese: \*\*\*, perfaqesuar ne gjykim nepermjet perfaqesueses me Autorizim nr. \*\*\* prot, dt. \*\*\*, \*\*\*, ne mungese.

2.Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, me adrese: \*\*\*, perfaqesuar ne gjykim nepermjet perfaqesueses me Autorizim nr. \*\*\* prot, dt. \*\*\*, \*\*\*, ne mungese.

**OBJEKTI:** Deklarimi i pavlefshmerise se regjistrimeve te markave \*\*\* (fjale dhe fjale & figure), respektivisht me nr. regjistrimi \*\*\*, date 16.01.2017, \*\*\* (fjale dhe figure) dhe nr. regjistrimi \*\*\*, date 05.10.2015, \*\*\* (fjale) nga subjekti tregtar \*\*\*, ne kundershtim me dipozitat e nenit 143, pika 1; pika 2, germa C; pika 3, germa C; dhe d; pika 5, germa C; te Ligjit "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar dhe shfuqizimin e regjistrimeve te markave te siperpernendura me efekt retroaktiv qe nga data e aplikimit per regjistrim te tyre, ne aplikim te nenit 173 te Ligjit "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31, 32, 36 dhe 348 te Kodit te Procedures Civile. Nenet 142, 143, dhe 173 te Ligjit nr.9947 dt.07.07.2008 “Per Pronesine Industriale”, i ndryshuar, nenet 638, 639 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

GJYKATA, pasi ; degjoi palen paditese, e cila perfundimisht kerkoi pranimin e

padise, palen e paditur, prezent gjate fazes se hetimit gjyqesor, ku prapesoi pretendimet e pales paditese, duke kerkuar rrezimin e padise, zhvilloi seancen e diskutimit perfundimtar ne mungese te kesaj pale, zhvilloi gjykimin ne mungese te personave te trete, analizoi provat dhe ceshtjen ne teresi,

**VEREN:**

Se pala paditese, Shoqeria „\*\*\*\*“, i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me padine kunder pales se paditur, \*\*\*, person fizik, dhe persona te trete; Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, me objekt; Deklarimi i pavlefshmerise se regjistrimeve te markave \*\*\* (fjale dhe fjale & figure), respektivisht me nr. regjistrimi \*\*\*, date 16.01.2017, \*\*\* (fjale dhe figure) dhe or. regjistrimi \*\*\*, date 05.10.2015, \*\*\* (fjale) nga subjekti tregtar \*\*\*, ne kundershtrim me dipozitat e nenit 143, pika 1; pika 2, germa C;; pika 3, germat C; dhe d; pika 5, germa C;; te Ligjit "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar dhe shfuqizimin e regjistrimeve te markave te siperpernendura me efekt retroaktiv qe nga data e aplikimit per regjistrim te tyre, ne aplikim te nenit 173 te Ligjit "Per Prone sine Industriale", i ndryshuar.

Ne aktin e kerkesepadise objekti i padise ka qene per konstatim te pavlefshmerise dhe gjithashtu, ka patur kerkesen procedurale per ; Dhenien e masave te nevojshme dhe te dobishme per ndalimin e menjehershem te veprimtarise se te Paditurit ne cenim te aktivitetit tregtar dhe te te Drejtave te Pronesise Intelektuale te shoqerise "\*\*\*\*" ne Shqiperi.

Ne lidhje me kerkesen procedurale per dhenien e masave te nevojshme dhe te dobishme, pala paditese, ne seancen pergatitore te dates 04.07.2017 deklaroi se hiqte dore. Nderkohe, gjate hetimit gjyqesor, bazuar ne nenin 185 te k.pr.civile, kerkoi ndryshimin e ketij objekti, sipas atij te percaktuar ne pjesen hyrese te vendimit, kerkese e cila u pranua nga Gjykata.

Padia eshte regjistruar fillimisht ne daten 31.05.2017, me nr. \*\*\* akti. Gjykata pasi zhvilloi hetimin gjyqesor, degjoi palen paditese ne diskutimin perfundimtar, ne mungese te paleve te tjera, ka shpallur vendimin nr. \*\*\*, ne daten 29.01.2018 me te cilin ka vendosur ; Te nxjerre jashte juridiksionit gjyqesor ceshtjen civile me nr. \*\*\*akti qe i perket paditesit , Shoqeria "\*\*\*\*", shoqeri e huaj.

Bazuar ne ankimin e bere nga pala paditese, Gjykata e Larte, me vendimin e saj nr. \*\*\*, dt 13.04.2018 ka vendosur prishjen e atij vendimi, dhe kthimin e ceshtjes per vazhdimin e gjykimit ne po ate gjykate. Ne kete vendim Gjykata e Larte arsyeton se, kjo ceshtje i perket juridiksionit gjyqesor. Pas kthimit te kesaj ceshtje nga Gjykata e Larte, eshte bere regjistrimi i saj ne daten 11.05.2018, me nr. \*\*\*, dt. 04.06.2018. Me dorezimin e kesaj ceshtje te ky trup gjykues, u vijua me vazhdimin e gjykimit ne veprimin procedural qe kishte mbetur ne momentin e marrjes se vendimit nr. \*\*\*, ne daten 29.01.2018. Gjykata ka thirrur palet per te relatuar vendimin e Gjykates se Larte dhe eshte terhequr per te shpallur vendimin perfundimtar.

Ne kete gjykim, paditesi pretendoi se: eshte një shoqëri tregtare me aktivitet ndërkombëtar, themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Kroacisë, me seli në \*\*\*, me NIPT \*\*\*, dhe qe vepron ne fushen e zhvillimit dhe prodhimit të

produkteve detergjente dhe higjenes personale dhe shtepiake qe prej vitit 1994. Ajo aktualisht eshte titullare e nje serë markash të mirenjohura si sinonim cilësie në publikun e gjerë, siç janë nder te tjera: \*\*\*.

Sipas vërtetimit noterial nr. \*\*\*, datë 1.11.2017, rezulton se në pronësi të shoqërisë \*\*\* është edhe marka tregtare “\*\*\*\*” (falë dhe falë & figurë) e cila është një markë nderkombëtare e mirënjohur dhe e regjistruar, kryesisht në klasen 3 të Klasifikimit të Nicës (produkte detergjente për higjenën personale dhe shtëpijake), që prej vitit 2004, ndër të tjera dhe në: Republikën e Kroacisë, Sllovenisë, Maqedonisë, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosovë. Marka “\*\*\*\*” (fjalë dhe fjalë & figurë), në pronësi të paditësit, është gjithashtu e pranishme dhe e mirënjohur dhe ne tregun shqiptar që prej vitit 2006, nëpërmjet kanaleve me shumicë dhe me pakicë, dhe gëzon reputacion në Shqipëri si rezultat i volumit të lartë të shitjeve me detergjentet e saj, të njohur dhe të vlerësuar në publikun e gjerë.

Paditësi është vënë në dijeni se z. \*\*\*, person fizik, regjistruar ne QKB me emrin tregtar “\*\*\*\*”, me NUIS \*\*\*, ka regjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale , për klasën 3 të Klasifikimit të Nicës, dy marka tregtare me nr. regjistrimi \*\*\*, datë 16.01.2017, \*\*\* (fjalë dhe figurë) dhe nr. regjistrimi \*\*\*, datë 05.10.2015, \*\*\* (fjalë) , të cilat janë riprodhim i pa autorizuar i të drejtave të pronësisë intelektuale mbi logon dhe emërtimin \*\*\*, dhe imitim servil i markës së regjistruar dhe mirënjohur në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar \*\*\*, në pronësi të shoqërisë \*\*\*. Regjistrimi i këtyre markave nga ana e te paditurit, i cili nuk gëzon të drejtën për regjistrimin e tyre, i bërë me qëllimin e vetëm që të nderhyjë dhe të konkurrojë në mënyrë te pandershme me aktivitetin tregtar të paditësit në Shqipëri, duke përfituar në mënyrë të paligjshme nga njohja dhe prestigji që marka \*\*\* gëzon tek konsumatori shqiptar, dhe duke shkaktuar në këtë mënyre edhe konfuzion tek ky i fundit në lidhje me origjinën dhe cilësinë e produkteve që i ofrohen - përben nje perdorim të padrejtë të së drejtës së markave tregtare për të arritur një qëllim të jashtëligjshëm, i cili është në kundërshtim me ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, dhe si i tille duhet të ndalohet nga ana e Gjykes, duke deklaruar pavlefshmërinë e regjistrimeve të markave të sipërpermendura të kryera nga ana e të paditurit, subjekti tregtar \*\*\*, të cilat janë në kundërshtim me nenet 143, pika 1; 143, pika 2, germa ç; 143 pika 3, germa ç dhe d; 143 pika 5, germa ç, të Ligjit “Për Pronësinë Industriale”, dhe rrjedhimisht t’i shfuqizojë ato në aplikim të nenit 173 të këtij ligji, duke filluar që nga data e aplikimit për regjistrim të tyre, me argumentat si vijon;

1. Gjithë argumentimi mbrojtës i palës së paditur bazohet mbi faktin se subjekti tregtar \*\*\* ka regjistruar marken \*\*\* pranë DPPI dhe se pala paditëse duhet të bënte kundërshtimet e saj përgjatë këtij regjistrimi përndryshe ajo nuk e ka më të drejtën të kundërshtojë këtë regjistrim. Ky argumentim i palës së paditur, është i gabuar në thelb dhe është në kundërshtim me parashikimet e ligjit të sipercituar, i cili parashikon ekzakhtësisht të kundërtën. Neni 143 parashikon që marka nuk mund të regjistrohet, ose nëse është e regjistruar deklarohet e pavlefshme, kur ekzistojnë ato që ligji i konsideron si shkaqe relative për refuzimin e regjistrimit të markës tregtare dhe që u referohen kryesisht të gjitha atyre rasteve kur marka është e njëjtë ose e ngjashme me një markë ose të drejtë pronësie intelektuale të mëparshme, markë e mëparshme e regjistruar; ose markë e mëparshme e përdorur de facto; e drejtë autori e mëparshme, etj. Ligji specifikon qartësisht faktin se, procedura e regjistrimit të markës pranë DPPI nuk ezauron mundësitë e kundërshtimit të saj nga ana e subjekteve të interesuara, dhe për rrjedhojë, marka që është regjistruar pa u plotësuar kushtet për regjistrim, mund të kundërshtohet dhe të deklarohet e pavlefshme edhe pas regjistrimit të saj, nga ana e

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është kompetente në bazë të nenit 4, par. 17, i LPI dhe 348 i K.Pr.C. I njëjti parim është sanksionuar edhe më pas nga neni 173.

2. Ekzistojnë një sërë arsyesh ligjore të cilat e bëjnë të pavlefshëm regjistrimin e markës \*\*\* të kryer nga pala e paditur, që janë: a) cënimi i të drejtes së mëparshme, e Drejta e Autorit, mbi markën dhe logon \*\*\* në pronësi të pales paditese, sipas nenit 143/3/ç të ligjit; b) cënimi i të drejtes së mëparshme të markës së paregjistruar, de facto, \*\*\* të fituar si rezultat i përdorimit dhe mirënjohjes në tregun shqiptar, sipas nenit 143/3/dc) cënimi i të drejtes së mëparshme të markës së regjistruar ose të barazuar me të (\*\*\*) e fituar si rrjedhojë e aplikimit në rastin konkret të nenit 6-Bis të Konventës së Unionit të Parisit, sipas nenit 143/2/a, b dhe c.d) regjistrimi i markës \*\*\* është kryer në keqbesim nga pala e paditur, sipas nenit 143/2/ç.

Ekzistenca e një të drejte të mëparshme mbi logon dhe markën \*\*\*. Siç rezulton nga provat e administruara në dosjen gjyqësore, Vërtetim noterial nr. \*\*\*, datë 1.11.2017, Marka dhe logoja \*\*\* (vetëm fjalë dhe fjalë & figurë) janë pronë intelektuale dhe janë të regjistruara në pronësi të shoqërisë \*\*\*, për produkte të klasës nr. 3 të Klasifikimit të Nicës që prej vitit 2004 (vetëm fjalë) dhe që prej vitit 2008 (fjalë & figurë); pamja e markave. Rezulton e provuar se që prej vitit 2006, sipas deklaratave doganore të importimit të mallrave me markën \*\*\* në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet distributorit të saj lokal, \*\*\*, shoqëria \*\*\*, me markën e saj, \*\*\*, është e pranishme dhe e mirënjohur edhe në tregun shqiptar. Në datat, 05.10.2015 dhe 16.01.2017, pra shumë kohë më vonë, i padituri, regjistron pranë DPPI, për klasën 3 të Klasifikimit të Nicës, dy marka tregtare, objekt kundërshtimi, respektivisht, fjalë dhe fjalë dhe figurë, që siç dallohet qartësisht në figurat vijuese 1 dhe 2, përbëjnë një riprodhim identik dhe imitim servil i markave dhe logove \*\*\* (fjalë dhe fjalë & figurë) në pronësi dhe në përdorim të shoqërisë\*\*\*. Duke qenë se paditësi gezon të drejta pronësie intelektuale të mëparshme dhe të mirënjohura në lidhje me keto marka dhe logo, markat e regjistruara nga i padituri në kundërshtim me ligjin dhe me parimet dhe Konventat Ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Intelektuale, si dhe në kundërshtim me parimet e besimit të mirë dhe korrektesës në marrëdhëniet tregtare sipas neneve 638 dhe 639 të Kodit Civil.

**Arsyet e shfuqizimit të markave të kundërshtuara të regjistruara nga \*\*\*;**

**I. Cënimi i të drejtave të mëparshme të pronësisë intelektuale (e Drejta e Autorit) mbi markën dhe logon \*\*\* në pronësi të \*\*\*, sipas nenit 143/3 germa ç. Kushtet e percaktuara në këto dispozite, janë kumulative dhe shterues, dhe që në këto rast plotësohen pasi; paraqitja grafike e logove të \*\*\* është një e drejte autorësie mbi një veper artistike në kuptim të ligjit "Për të drejtën e autorit në Republikën e Shqipërisë" dhe kjo bazohet në nenin nenit 3 dhe 7 të Ligjit. Edhe pse në rastin e paditësit kemi të bëjmë me një logo, paraqitje grafike e markës tregtare, një logo e cila paraqet një grafikë origjinale, produkt i punës krijuese të mendjes së njeriut, nuk mund të perjashtohet nga mbrojtja që i ofron ligji për të drejtën e autorit. Bazuar në sa më sipër, paditësi gezon mbrojtjen e ofruar nga ky ligj mbi krijimin origjinal të logove të tij. Sipas nenit 5 të ligjit për autorin, mbrojtja që ofrohet nuk i nënshtrohet ndonjë formaliteti paraprak dhe si e tillë e drejta e autorit mbi një veper lind në momentin e krijimit. Gjithsesi, paditësi i referohet regjistrimeve të markave ndërkombëtare dhe përdorimit të tyre në Republikën e Shqipërisë, dhe që, rezultojnë respektivisht në vitin 2004, regjistrim i markës \*\*\* fjalë, në Republikën e Bosnjes dhe Hercegovinës, në vitin 2008 regjistrim i markës dhe logove \*\*\* fjalë dhe figurë në Republikën e Kroacisë, dhe në vitin 2006 që është edhe fillimi i përdorimit dhe njohja nga konsumatorët e Republikës së Shqipërisë. Datat e aplikimit dhe përdorimit të këtyre markave dhe**

logove në pronësi të \*\*\*, deshmojne se krijimi origjinal “\*\*\*\*” ka lindur disa vite me pare (respektivisht, 2004, 2008 dhe 2006), pra shume kohe perpara regjistrimit te Markave te Kundërshtuara (respektivisht 2015 dhe 2017).

II. Cënimi i të drejtave të mëparshme të markës së peregjistruar (de facto) \*\*\* të fituara si rezultat i përdorimit dhe mirënjohjes në tregun shqiptar, sipas nenit 143, pika 3, gërma d. Një arsye tjetër që i shtohet asaj të sipërpërmendur për shfuqizimin e markave të kundërshtuara, bazohet në nenin 143/ 3, gërma d. Kjo dispozite, merr parasysh dhe rregullon ekzistencën dhe përdorimin e asaj të drejte të pronësisë industriale që njihet me emrin e markës së peregjistruar ose de facto, nga ana e doktrinës juridike (rregulluar ne nivel European, nga neni 8, par. 4, Reg. CE 207/2009), të drejtat mbi të cilën lindin, jo si pasojë e regjistrimit të saj, por si rrjedhojë e përdorimit të vazhdueshëm për një kohë të gjatë në një aktivitet tregtar dhe shtrirja e gjerë territoriale. Kushtet e parashikuara nga norma për ekzistencën e një marke të mëparshme të peregjistruar, de facto, me janë: përdorimi i një shenje (fjalë ose figurë) në formë marke për dallimin e produkteve ose sherbimeve në një aktivitet tregtar, për një kohë të gjatë dhe shtrirje të gjerë territoriale; kjo markë e mëparshme e peregjistruar të jetë e njëjtë ose e ngjashme me marken e mëvonshme të regjistruar për të cilën kërkohet shfuqizimi, produktet ose sherbimet të jenë të njëjtë ose të ngjashëm. Përsa i përket kushtit te pare, në rastin konkret ndodhemi përballë asaj që ligji e pershkruan si përdorim të vazhdueshëm të një shenje në formë marke për një kohë të gjatë në një aktivitet tregtar dhe shtrirja e gjerë territoriale. Siç vertetohet nga provat e administruara ne dosjen gjyqësore, shoqëria \*\*\* importon dhe tregton, detergjentet me markën \*\*\* në Republikën e Shqipërisë që prej vitit 2006. Konsumatorët, falë reklamimit të rëndësishëm mbarë kombëtar në të gjitha televizionet me shtrirje kombëtare, tashmë lidhin produktet dhe markën \*\*\* më cilësinë e produkteve të ofruara nga \*\*\*. Pala paditese do të pësonte një dëm, dhe te konsumatorët do të shkaktohej konfuzion, nëqoftëse do të vazhdonte të lejohej regjistrimi i nje marke tjetere e identike e një subjekti tjetër. Përsa i përket kushtit te dyte, në rastin konkret është e pamohueshme, pasi nga krahasimi mes markave të kundërshtuara dhe atyre kundërshtuese, markat janë pothuajse identike. Edhe kushti i fundit, ngjashmëria ose identiteti i produkteve të cilave iu referohen markat përkatëse, plotësohet ne rastin konkret, pasi të dyja markat, përdoren dhe janë regjistruar për produkte të klasifikuara sipas klases nr. 3 të Klasifikimit të Nicës.

III. Ekzistenca e të drejtes së mëparshme të markës së regjistruar ose te barazuar me të (\*\*\*) e fituar si rrjedhoje e aplikimit ne rastin konkret te nenit 6-Bis të Konventës së Unionit të Parisit, sipas nenit 143, pika 2, gërmat a, b dhe c . Në bazë të nenit 143, pika 2, gërmat a, b dhe c dhe pika 5 gërma ç, të këtij neni parashikohet që: “Marke e meparshme, ne kuptim te pikes 2 te ketij neni, vleresohet: [...] ç) marka, e cila, ne daten e aplikimit per regjistrim, ose ne daten e prioritetit, ne rastet kur pretendohet per prioritet, eshte e mirenjohur ne Republikën e Shqiperise, ne kuptim te nenit 6 bis te Konventes se Parisit, te publiku i sektorit perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimit ose reklamimit”. Në bazë të nenit 6-Bis të Konventës së Unionit të Parisit, parashikohet që: “Shtetet anetare te Unionit impenjohen qe te refuzojne ose shfuqizojne, kryesisht,ose me kerkese te interesuarit, regjistrimin dhe te ndalojne perdorimin e nje marke tregtare per produkte apo sherbime qe eshte riprodhimi, imitimi apo perkthimi, ne menyre qe te shkaktoje konfuzion, i nje marke qe autoriteti kompetent i vendit te regjistrimit ose te perdorimit, do te vleresoje qe eshte aty e mirenjohur si marke e nje subjekti qe perfiton nga mbrojtja ne baze te kesaj Konvente dhe qe perdoret per produkte te njejte ose te ngjashem...”. Për aplikimin e nenit 6-Bis të Konventës, dhe për rrjedhojë të nenit 143, pika 5, gërma ç, të kërohet që të plotësohen

këto kushte kumulative:që marka të jetë e regjistruar në një Shtet anëtar të Konventës së Parisit (në pronësi të një subjekti që përfiton nga mbrojtja e Konventës); që marka të jetë e mirënjohur në territorin e Shtetit ku kërkohet mbrojtja, tek publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit. Ne rastin konkret, te dyja kushtet e parashikuara ekzistojne. Për rrjedhojë, në aplikim te nenit 143, pika 5, gërma ç, marka \*\*\* në pronësi të shoqërisë tregtare \*\*\*, duke qenë së është një markë e mirënjohur në territorin e Republikës së Shqipërisë, gëzon të njëjtën mbrojtje në këtë territor, sikur të ishte një markë aty e mëparëshme e regjistruar.

IV. Shfuqizimi i regjistrimit të markës \*\*\* të bërë në keqbesim nga aplikuesi \*\*\*, sipas nenit 143, pika 2, gërma ç. Regjistrimi i markave te kundershthuara eshte bere ne keqbesim, me qellimin e vetem per te cenuar aktivitetin e ligjshem dhe te ndershem te titullarit legjitim te markave \*\*\* ne Shqiperi, \*\*\*, dhe per te perfituar ne menyre te pandershme. Në bazë të të drejtës së Bashkimit Europian dhe të jurisprudences së GjDBE, regjistrimi i nje marke konsiderohet ne keqbesim dhe si i tille i pavlefshem, edhe ne rastin kur regjistruesi eshte ne dijeni te ekzistences se markes se regjistruar ne nje shtet tjetër dhe e regjistron ate me qellimin per te cenuar aktivitetin ekonomik dhe per te konkuruar ne menyre te pandershme nepermjet ushtrimit e se drejtes se markes per te ndaluar importimet ne vend te pronarit te ligjshem apo per te nxjerre perfitime ne menyre te paligjshme nepermjet shantazhit apo shitjes, me cmicm jashte tregut, te markes, abuzivisht te regjistruar, kundrejt titullarit te ligjshem. Sipas Vërtetim noterial nr. \*\*\*, datë 1.11.2017, aktualisht, i padituri, ka të regjistruar ose eshte në fazë regjistrimi pranë DPPI më shumë se 12 aplikime per marke, te cilat jane marka te regjistruara jashte vendit dhe ne perdorim te subjekteve te huaja qe importojne mallra apo sherbime ne territorin e Shqiperise. Duket qarte ne kete menyre, se qëllimi i regjistrimit të një numri kaq të lartë markash që u perkasin subjekteve të huaj prodhues dhe importues, eshte përdorimi abuziv i të drejtës së markës për të arritur qëllime dhe perfitime të pandershme, veprime këto që janë në kundërshtim jo vetem me shpirtin dhe ligjin material që rregullon të drejten e markave tregtare, por edhe me dispozitat e Kodit Civil që ndalojnë dhe ndërshkojnë konkurrencën e pandershme.

Pala e paditur, nepermjet perfaqesuesit te saj. Av. \*\*\*, prezent gjate gjithe gjykimit, pervec fazes se diskutimit perfundimtar, prapesoi keto pretendime duke kerkuar rrezimin e padise, me arsyetimin se;

1. Marka e tij eshte e regjistruar ne teritorin shqiptar sipas procedurave ligjore, sipas nenit 145, 146, 150/a, 151, 151/a, 155 te ligjit 9947/2008, "Per pronesine industriale". Ne momentin e regjistrimit nuk ka pasur prima face, nje karakter te mirenjohur te markes ne vend. Sipas nenit 143/5 te ligjit, konsiderohet marke e meparshme ajo qe ne daten e aplikimit eshte e mirenjohur ne Republikën e Shqiperise ne kuptim te nenit 6 bis te Konventes se Parisit, te publiku perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimi ose reklamimit. Rezultoi se ne daten e regjistrimit te kesaj marke tregtare me nr. \*\*\* dhe \*\*\* jane mare ne konsiderate keto elemente dhe pas verifikimit ne WIPO, nga DPPI nuk eshte identifikuar asnje marke tregtare qe gëzon mbrojtje ne territorin shqiptar.

2. Pala paditese pretendon, mbeshtetur ne Marreveshjen dhe Protokollin e Madritit, se gëzon prioritetin e regjistrimit kombetar, ne dt 23.02.2004, date ne te cilen ajo ka bere nje regjistrim kombetar te markes \*\*\*, ne Bosnje dhe Hercegovine, por ajo nuk ka perdorur instrumenat nderkombetare per te shtrire mbrojtjen dhe ne Shqiperi. Ne regjistrin e WIPO, kjo marke e pales paditese nuk figuron e regjistruar. Duke ju referuar Protokollit te Madritit, nenet 3bis, 3ter, 4, dhe Konventes se Parisit, pala paditese nuk gëzon mbrojtje ne territorin shqiptar, per sa kohe nuk ka respektuar

parashikimet ne instrumentat nderkombetare.

Personi i trete ne kete gjykim, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, u paraqit vetem ne nje senacen pergatitore te dates 12.10.2017 ne te cilen deklaroi se regjistrimi i markave te kundershura nga ana e kesaj drejtorie eshte bere ne perputhje me ligjin.

Personi i trete ,Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, ka qene prezent ne kete gjykim vetem ne dy seanca pergatitore te cilat nuk jane zhvilluar per shkak te moskonfirmimit te dijenise se pales se paditur. Ne keto kushte nga ana e kesaj pale nuk pati asnje qendrim ne lidhje me kete padi.

Gjykata, ne analize te pretendimeve dhe prapesimeve, provave te paraqitura nga palet, ligjit material dhe procedural, çmon se padia eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille pranohe, me arsyetimin se ;

Se pari, kjo padi eshte paraqitur ne kete gjykate ne dt 30.05.2017 dhe rregjistruar ne dt 31.05.2017. Ne kete kohe, ligji nr. 9947, dt.07.07.2008, “Per pronesine industriale”, eshte ndryshuar me ligjin nr. 17, dt 16.02.2017, i botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 43, dt 09.03.2017, dhe ka hyre ne fuqi ne daten 24.03.2017.

Sipas dispozitave kalimtare, neni 47 te ligjit ndryshues, ligji i pandryshuar, do te zbatohet vetem per :

1. Per procedurat e regjistrimit te te drejtave te pronesise industriale, qe nuk kane perfunduar deri ne daten e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit ne fuqi ne çastin e aplikimit.
2. Per procedurat e shkeljeve te te drejtave te pronesise industriale, qe nuk kane perfunduar deri ne daten e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit ne fuqi ne çastin e fillimit te procedureve.

Nisur nga kjo suate legislative, Gjykata, per te shqyrtuar kete padi, do ti referohet dispozitave te ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, “Per pronesine industriale”, ndryshuar me ligjin nr. 17, dt 16.02.2017. Sipas pales paditese, pretendimi per shkelje te se drejtes industriale, e konkretisht asaj te markes tregtare, eshte paraqitur per here te pare ne kete gjykate, me kete padi. Ne keto rrethana, nuk ka vend zbatimi i rasteve kur zbatohet ligji i pandryshuar, pasi sipas nenit 47 te ligjit ndryshues, i sipercituar, nuk eshte asnje nga rastet.

Se dyti, ne kete gjykim rezultoi e provuar se pala e paditur, \*\*\*, subjekt fizik, regjistruar me emerin tregtar “\*\*\*\*”, me NUIS \*\*\*, ka regjistruar markat me nr. regjistrimi \*\*\*, date 16.01.2017, \*\*\* (fjale dhe figure) dhe nr. regjistrimi \*\*\*, date 05.10.2015, \*\*\* (fjale).

Se treti, ky regjistrim nga personi i trete, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, nuk kundershtohet nga pala paditese si e kryer ne kundershtrim me nenin 142 te ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, “Per pronesine industriale”, i ndryshuar. Sipas kesaj dispozite, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, nuk duhet te regjistroje asnje marke tregtare nese ekzistojne shkaqet qe percaktohen ne te.

Prapesimi i pales se paditur se, keto shkaqe nuk kane ekzistuar, eshte i pavend, ashtu si

dhe argumenton pala paditese, pasi pretendimi i kesaj te fundit nuk ka lidhje me kete situatë.

Se katerti, neni 173, pika 1/a dhe 3 e ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Per pronesine industriale", i ndryshuar, parashikon se ; 1. Nje marke e regjistruar mund te shfuqizohet kur:

a) regjistrimi i markes eshte bere ne shkelje te parashikimeve te neneve 142 e 143, te ketij ligji, ne kohen kur eshte depozituar aplikimi per regjistrim;... 3. Çdo marke e regjistruar qe shfuqizohet, konsiderohet si e paqene, duke filluar nga data e depozitimit te markes.

Ne kete gjykim pala paditese provoi se, ne rastin e regjistrimit te ketyre markave nga pala e paditur, nuk permbushen disa nga kerkesat e nenit 143, te cilat njeheresh cenojne te drejta e saj dhe i japin legjitimin, sipas nenit 173/1 te sipercituar, te drejten per te kerkuar shfuqizimin e ketyre markave, shfuqizim i cili vleresohet si i paqene nga data e depozitimit te markes.

Per kete konkluzion Gjykata bazohet ne arsyetimin se;

a) pala paditese provoi ne kete gjykim se regjistrimi i ketyre markave eshte bere ne kundërshtim me nenin 143/3 germa ç te ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Per pronesine industriale", i ndryshuar, i cili percakton se; 3. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejta e meparshme, te fituara, si:... ç) te drejta e autorit te nje vepre ose te nje pjese te saj, me kusht qe ajo te jete e njejte ose e ngjashme me marken, qe kerkohet te mbrohet.

Ashtu si dhe pretendon pala paditese, sipas vertetimit noterial nr. \*\*\*, dt 01.11.2017, vertetohet se marka dhe logoja "\*\*\*\*", vetem fjale dhe fjale dhe figure, jane prone intelektuale e pales paditese te regjistruara per produkte te klases nr.3, te Klasifikimit te Nices, qe kane te bejne me preparate zbardhuese dhe substanca te tjera per larje rrobash, preparate pastruese , lustruese, pasta dhembesh, etj., nga viti 2004, vetem per fjale dhe nga vitit 2008 , fjale dhe figure. Nderkohe, sipas deklarave doganore te importimit te mallrave me marken \*\*\*, rezulton se nga viti 2006 pala paditese , nepermjet distributorit te saj ne Shqiperi, ka sjelle dhe tregtuar keto lloj mallrash me kete marke dhe me keto logo, duke qene e mirenjohur ne tregun shqiptar. Ne keto kushte, kur jane bere regjistrimet e markave te pales se paditur, ne dt 05.10.2015 dhe 16.01.2017, per te njejten klase te Klasifikimit te Nices, markat dhe logot \*\*\* te pales paditese kishin shume kohe qe ishin regjistruar nderkombetarisht dhe te pranishme dhe te mirenjohura ne Shqiperi.

Nga ana tjeter, keto regjistrime nga pala e paditur me fjale, dhe fjale dhe figure, jane identike me ato te pales paditese.

Ne referimit te nenit 3 dhe 7 te ligjit 9380/2005 "Per te drejta e autorit dhe te drejta e tjera te lidhura me te" ne fuqi ne kohen e regjistrimit te pare dt 05.10.2015 dhe neneve 2/1 dhe 8/1/dh te ligjit 35/2016 "Per te drejta e autorit dhe te drejta e tjera te lidhura me to" i cili ka qene ne fuqi ne kohen e regjistrimit te dyte, dt 16.10.2017, keto logo te perdorura nga pala paditese gezojne te drejten e autorit te fituar me pare nga ana e saj. Ne keto kushte, regjistrimet e markave nga pala e paditur, identike me ato te pales paditese, bazuar ne nenin 143/3/ç dhe 173/1 te ligjit , deklarohen te pavlefshme dhe si te tilla shfuqizohen, shfuqizim i cili vleresohet si i paqene nga data e depozitimit te



markes.

Ne lidhje me faktet e pretenduara nga pala paditese, qe kane te bejne ;

-ngjashmerine e markave ne fjale dhe fjale dhe figure te te dy paleve si dhe

-pranine e ketyre produkteve te pales paditese, me kete marke dhe me kete logo, ne tregun shqiptar,

nga pala e paditur nuk pati asnje prapesim apo kundershtrim. Si dhe u pasqyrua ne pjesen e prapesimeve te pales se paditur, prej saj u pretendua vetem fakti qe markat e pales paditese nuk jane te regjistruara ne Shqiperi, fakt ky qe nuk pretendohet nga pala paditese dhe nuk eshte shkak ligjor i kerkimeve te saj.

b) pala paditese provoi ne kete gjykim se regjistrimi i ketyre markave eshte bere ne kundershtrim edhe germen d, te nenit 143/3 te ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Per pronesine industriale", i ndryshuar, i cili percakton se 3. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si:...; d) te drejtat e nje marke te paregjistruar ose nje shenje tjetere, te fituara nga perdorimi per nje kohe te gjate ne nje aktivitet tregtar dhe shtrirja e gjere territoriale."

Pala paditese provoi se;

- eshte e pranishme ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, nga viti 2006, me produktet te cilat i tregton nen marken \*\*\* dhe ne lidhje me kete fakt, pala e paditur nuk beri asnje prapesim apo kundershtrim.

-si dhe u arsyetua me lart, kjo marke nuk eshte thjesht e ngjashme me markat e regjistruara nga pala e paditur, por jane identike dhe kjo e fundit edhe per kete fakt nuk prapesoi apo kundershtoi.

- produktet e markes se pales paditese qe tregtohen nen marken \*\*\* jane te njejta me ato te pales se paditur qe tregtohen nen markat e regjistruara, objekt kundeshtimi. Edhe per kete fakt pala e paditur nuk pati asnje prapesim apo kundershtrim.

Ne keto kushte, regjistrimet e markave nga pala e paditur, identike me ato te pales paditese, deklarohen te pavlefshme edhe sipas nenit 143/3/d te ligjit te ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Per pronesine industriale", i ndryshuar.

c) pala paditese provoi ne kete gjykim se regjistrimi i ketyre markave eshte bere ne kundershtrim edhe me piken 2, gerrat a,b dhe c te nenit 143 te ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Per pronesine industriale", i ndryshuar, te cilat percaktojne se ;..2. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur:a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme;b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;c) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, edhe kur eshte per t'u regjistruar ose eshte regjistruar per mallra apo sherbime, qe nuk jane te ngjashme me ato, per te cilat eshte regjistruar marka e meparshme, kur marka e meparshme ka nje reputacion ne Republikën e Shqiperise dhe perdorimi ose regjistrimi i markes ne fjale, pa shkak te arsyeshem, fiton prioritet te padrejte ose demton natyren dalluese apo emrin e mire te markes se meparshme.

Pika 5 germa ç e nenit 143 percakton se; 5. Marke e meparshme, ne kuptim te pikes 2 te ketij neni, vleresohet:.....ç) marka, e cila, ne daten e aplikimit per regjistrim, ose ne daten e prioritetit, ne rastet kur pretendohet per prioritet, eshte e mirenjohur ne

Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.

Neni 6 bis i Konventës së Parisit, në të cilën Republika e Shqipërisë është antare nga data 04.10.1995, përcakton se ; Shtetet antare të Unionit marrin përsiper që, kryesisht ose me kërkesë të të interesuarit, të refuzojnë ose shfuqizojnë, regjistrimin dhe të ndalojnë përdorimin e një marke tregtare për produkte apo shërbime që është riprodhim, imitim apo përkthim , në mënyrë që të shkaktojë konfuzion , i një marke që autoriteti kompetent i vendit të regjistrimit ose të përdorimit, do të vlerësojë që është aty e mirënjohur si marke e një subjekti që përfiton nga mbrojtja në bazë të kesaj Konvente dhe që përdoret për produkte të njëjta ose të ngjashme..."

Pala paditëse, provoi se e ka të regjistruar këto marke identike me ato të pales së paditur, për produkte të njëjta, në shtetin e saj të origjinës, Kroaci, në dt 14.03.2008 dhe ndërkohe ky shtet është antar i Konventës së Parisit, nga viti 1991.

Në këto kushte, regjistrimet e markave nga pala e paditur, identike me ato të pales paditëse, deklarohen të pavlefshme edhe sipas nenit 143/2, germa a,b, dhe c të ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.

d) pretendimi i pales paditëse, se këto regjistrime janë bërë edhe në keqbesim nga pala e paditur, si shkak tjetër për të deklaruar ato të pavlefshme sipas pikës 2 germa ç e nenit 143, të ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, nga Gjykata vlerësohet se i pabazuar në prova.

Për të provuar këte pretendim pala paditëse referohet në faktin se pala e paditur ka aplikuar pranë DPPI për më shumë se 12 aplikime të tjera për marka të tjera të njohura të regjistruara jashtë vendit dhe në përdorim të subjekteve të tjera të huaja që importojnë mallra apo shërbime në territorin e Shqipërisë. Për këte fakt pala paditëse paraqiti vetëm vertetimin noterial nr. \*\*\*, dt 01.11.2001, sipas të cilit nga konsultimi me portalin online të DPPI në Shqipëri ka rezultuar se pala e paditur, ka aplikuar apo regjistruar 12.

Ndërkohe, pala paditëse nuk provoi me asnjë provë se këto marka i perkasin markave të subjekteve të tjera të regjistruara jashtë Shqipërisë.

Gjykata vlerëson se vetëm fakti i aplikimit për regjistrim apo regjistrimi i këtyre markave të tjera nga pala e paditur, nuk mund të provojë keqbesimin e saj në regjistrimin e markave objekt kundërshtimi në këte gjykim.

Per keto arsye

Gjykata në bazë të neneve 105, 106, 126, 306, 308, të Kodit të Procedurës Civile, nenit 143/2, germa a,b,c , 143/3 germa ç , d, nenit 173/1/a dhe 173/3 të ligjit nr. 9947, dt.07.07.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar

**VENDOSI**

-Pranimin e paditës së paditësit Shoqëria „\*\*\*“, shoqëri e huaj.

-Deklarimin e pavlefshëm dhe shfuqizimin e regjistrimeve të markave me nr. regjistrimi

**\*\*\*, date 16.01.2017, \*\*\*, fjale dhe figure, dhe me nr. regjistrimi \*\*\*, date 05.10.2015, \*\*\* , fjale, te cilat konsiderohen si te paqene nga data e depozitimit te markes, nga pala e paditur \*\*\*, subjekt fizik, regjistruar me emrin tregtar “\*\*\*\*”.**

**-Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.**

**-Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes se vendimit.**

**-Per palet ne mungese ky afat fillon nga dita e neserme njoftimit te vendimit.**

**U shpall ne Tirane me 04.06.2018**

**SEKRETARE**

**Alsma SHEHU**

**GJYQTAR**

**Brunilda KADI**

**Shpenzime gjyqesore  
Takse padie - \*\*\* leke**

**\*\***